

EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6175
E enje, 26 nëntor 2020
çmimi 0.40 €

Balaj-Halimaj e Grubi
dakordohen për
mbledhjen e përbashkët
Kosovë-Maqedoni | FAQE 3



FLET PËR "EPOKËN E RE" NËNKRJETARI I PARTISË DEMOKRATIKE
TË KOSOVËS (PDK), SHAQIR TOTAJ | FAQE 4-5



PDK-ja NUK E KA PRIORITET PËRFSHIRJEN NË QEVERI

Nënkrjетari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Shaqir Totaj, ka thënë se ky subjekt politik nuk e ka prioritet përfshirjen në qeverinë Hoti. Në këtë intervistë dhënë për gazeten "Epoka e re", ai ka theksuar se PDK-ja do të

qëndrojë në opozitë. "PDK-ja nuk e ka prioritet çështjen e hyrjes në qeveri. Ne e respektojmë vendimin e qytetarëve që është dhënë më 7 tetor si dhe deklaratën e kryetarit Veseli, i cili ka thënë se PDK-ja do të qëndrojë në opozitë", është

shprehur ai. Totaj ka thënë se zgjedhjet e reja duhet të janë opsioni i fundit për Kosovën. Ai ka thënë se të gjithë aktorët politikë duhet të kenë një qasje konstruktive për një zgjidhje tjetër para se të mendojnë për zgjedhje të reja



1 651 TESTIME, NËNTË PACIENTË TË VDEKUR DHE 704 RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË | FAQE 3

Në Kosovë situata epidemiologjike vazhdon të mos ketë ndryshime, pasi autoritetet regjistrojnë me qindra raste të infektuarve në

baza ditore. Të mëkurën Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShPK) se gjatë 24 orëve të fundit, nga 1 651 mostra të testuara, 704

kanë dalë pozitive me Covid-19. Sipas raportit, gjatë kësaj periudhë janë shënuar edhe nëntë raste të vdekjes

A MUND TË
ZGJEROHET
JURIDIKSIONI
I GJYKATËS
SPECIALE? | FAQE 2



MILIONAT QË NUK SOLLËN DRITË



| FAQE 9

RENOVA
PUTZ
Makedoni Xheqci - Tetovë Curë - Ferizaj Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755 Fax: +389 44 487 200 Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com


Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

[facebook.com Gazeta "Epoka e re"](#)



AKTUALE



LANSOHET PROJEKTI "HERAS PLUS" QË SYNON MBËSHTELJEN E ARSIMIT TË LARTË NË KOSOVË | F. 7

PËRMBYLLJE E SUKSESSHME E STËRVITJES FUSHORE "UJKU VIGJILENT-02" | F. 5

FERID AGANI PROPOZOHEZ PËR PRESIDENT | F. 6

KULTURË

DUMOSHI: BIBLIOTEKA KOMBËTARE, TEMPULL I DIJES KU KANË KALUAR GJENERATA INTELEKTUALËSH | F. 8



SPORT

'DARDANËT' PËR FITORE NDAJ SILOVAKISË | F. 8



Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.
DEGA KOSOVO
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

A mund të zgjerohet juridiksioni i Gjykatës Speciale?

PRISHTINË, 25 NËNTOR- Nuk është e pamundur që Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë, që njihen si Gjykatë Speciale për krimet e luftës në Kosovë, të hetojnë dhe gjykojnë të gjithë krimet që janë kryer gjatë luftës në Kosovë dhe jo vetëm krimet e pretenduara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), thotë Enver Hasani, profesor i të Drejtës dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Por, sipas tij, për një gjë të tillë, është i domosdoshëm ndryshim-plotësimi i bazës së amendamentit kushtetuese. Nenit 162 të Kushtetutës së Kosovës, që i dedikohet Dhomave të Specializuara, si dhe revidimi i nenit 6 të ligjit përkëto dhoma. Por, për të gjitha këto, siç thotë profesor Hasani, rrjedhimisht nevojitet vullneti politik i brendshëm dhe ndërkombëtar, si dhe koordinimi ndërmjet këtyre faktorëve.

Njohësi i cështjeve politike, Armend Muja, vlerëson që deri më tash ka munguar guximi politik brenda spekrit politik të Kosovës, që të iniciojë ndryshimet e nevojshme kushtetuese dhe ligjore, për zgjerimin e mandatit të Dhomave të Specializuara, në mënyrë që të hetohen dhe gjykojen të gjithë krimet, nga kushdo që janë kryer në Kosovë gjatë luftës së fundit.

Çfarë thonë Kushtetuta dhe Ligji për Dhomat e Specializuara?

Në nenin 162 të Kushtetutës së Kosovës, thuhet që Republika e Kosovës mund të themelojë Dhomat e Specializuara dhe një Zyra të Prokurorit të Specializuar në kuadër të sistemit të drejtësisë në Kosovë "për t'i përmbyllur obligimet ndërkombëtare në lidhje me Raportin e Asamblesë së Përgjithshme të Këshillit të Evropës, Dokumenti 12462, të datës 7 janar, 2011".

Në Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, në Nenin 6, i cili flet për juridikcionin lëndor, thuhet se "Dhomat e Specializuara kanë juridikcion mbi krimet e parapara në net 12 - 16, që kanë të bëjnë me Raportin e Asamblesë së Këshillit të Evropës". Por, në raportin prej 42 faqesh të Asamblesë së Përgjithshme të Këshillit të Evropës, në asnjë faqe dhe me asnjë fjalë nuk cekën krimet e forcave serbe të kryera në Kosovë, por vetëm pretendimet për krimet e kryera nga pjesëtarët e UÇK-së.

Hasani: Zgjerim juridiksioni të Dhomave të Specializuara ose gjykatë e re

Profesori i të Drejtës dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Enver Hasani, ish-kryetar i

Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, thotë për "Radion Evropa e Lirë" që edhe në pjesën hyrëse të Nenit 162 të Kushtetutës së Kosovës, por edhe në Ligjin për Dhomat e Specializuara, "bëhet fjalë saktësish vetëm për hetimin dhe gjykimin e krimeve të pretenduara se i kanë kryer shqiptarët dhe nuk flitet për krimet e kryera nga serbët në territorin e Kosovës apo në ndonjë territor tjeter".

Për të hetuar dhe gjykuar krimet e kryera nga ana e serbëve gjatë luftës në Kosovë, profesor Hasani thotë se duhet kriuar një gjykatë e re ose të zgjerohet juridiksioni i Dhomave të Specializuara, përmes ndryshimeve kushtetuese në Nenin 162 të Kushtetutës së Kosovës.

Sipas tij, baza aktuale kushtetuese, amendamenti i Kushtetutës, Nenin 162, për Dhomat e Specializuara, ka qenë detyrim ndërkombëtar i Kosovës që ka dalë nga rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Këshillit të Evropës, e që buron nga raporti i eurodeputetit zviceran, Dick Marty.

"Kjo nënkupton që për të ushtruar juridiksioni për krimet e forcave serbe që janë kryer në territorin e Kosovës, duhet një hetim i ri, përkatësish një bazë e re kushtetuese, një bazë e re ligjore, që do të thotë se gjithçka duhet të nisi prej zeros. Unë nuk shoh se si mund të ndryshohet obligimi bazë dhe fillestar. Duhet të bëhet edhe një rezolutë tjeter e Asamblesë (së Përgjithshme të Këshillit të Evropës) për ta zgjeroar pastaj amendamenti kushtetues.

Shkurt, duhet procedurë tjeter, sepse është rregull ndërkombëtar që një detyrim ndërkombëtar kontraktual, siç është ky, që merret me vullnet, duhet që në të njëjtën mënyrë të anullohet ose të ndryshohet në të njëjtën mënyrë me të cilën është marrë", tha Hasani.

Njohësi i zhvillimeve politike, Armend Muja, duke folur për "Radion Evropa e Lirë", shpreh mendimin se deri më tash në Kosovë ka munguar guximit politik për shqyrta dhe iniciuar mundësinë e krijimit të një mekanizmi të ri juridik për hetimin dhe gjykimin e krimeve të forcave serbe gjatë luftës në Kosovë ose për të imponuar zgjerimin e juridiksionit të Dhomave të Specializuara. Por, sipas tij, Kosova duhet që me ndihmën e eksperëtive ndërkombëtarë të revidojë Nenin 6 të Ligjit për Dhomat e Specializuara. Kjo, sipas tij, nuk duhet të bëhet me qëllimin e minimit ose dekurajimit të Dhomave Speciale, por për të plotësuar mandatin e tyre. "Unë nuk pres që (lidhur me një nismë të tillë) të ketë reagime në planin ndërkombëtar, për arsy se revidimi është, në njëfarrë mënyre, njësim i qëndrimit të Kosovës me qëndrimin ndërkombëtar. Atëherë nuk do të kishte një



fokusim të tillë, nuk do të kishte një këndvështrim (kundërshtues) sikurse nisma të vinte jo me motive për ta minuar Gjykatën Speciale, por për ta plotësuar atë. Pra, sikur plotësimi të ishte si nismë, unë nuk mendoj që kjo nuk do të haste në rezistencë ndërkombëtare", theksoi Muja.

Engel: Të ekzaminohet puna e Gjykatës Speciale

Kryetari i Komitetit për Punë të Jashtme në Dhomën e Përfaqësuesve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Eliot Engel, më 5 nëntor, ka kritikuar Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, pasi sipas tij, kanë shënjestruar vetëm qytetarët e një etnie, shqiptarët.

Engel ka theksuar që statusi që ka kriuar Gjykatën Speciale, nuk e ka kufizuar atë që të merret vetëm me shqiptarët dhe se "ligji thotë se juridiksioni i gjykatës është për krimet e luftës që janë bërë në Kosovë gjatë një kohe të caktuar në periudhën e luftës". "Ekuptoj se Qeveria serbe dëshirat e zgjaturat e gjykatës Speciale, nuk e ka kufizuar atë që të merret vetëm me shqiptarët dhe se "ligji thotë se

juridiksioni i gjykatës është për krimet e luftës që janë bërë në Kosovë gjatë një kohe të caktuar në periudhën e luftës". "Ekuptoj se Qeveria serbe dëshirat e zgjaturat e gjykatës Speciale, nuk e ka kufizuar atë që të merret vetëm me shqiptarët dhe se "ligji thotë se

Kërkesat në raport me Dhomat e Specializuara

Më 14 nëntor 2020, partia Nisma Socialdemokrate, përmes një konference për shtyp të zyrtarëve të saj, ka kërkuar nga Gjykata Speciale që të sqarojë nëse janë duke përgatitur aktakuza ndaj përfaqësuesve të shtetit serb që kanë qenë të përfshirë, siç është thënë, "në kryerjen e genocidit në Kosovë". Më 14 gusht 2020, Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka kërkuar nga grupet

të Specializuara mund të zgjerohet. Sipas tij, tashmë nuk ekziston droja e eliminimit të Dhomave të Specializuara, sikurse që ishte provuar në dhjetorin e vitit 2017, me nismën e 43 deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Sipas tij, aktualisht, shoqëria në Kosovë, por edhe aktorët politikë ndërkombëtarë, mund të jenë më të hapur për të dëgjuar argumentin për zgjerimin e juridiksionit të Dhomave të Specializuara. "Kjo do të ndodhë dhe duhet të ndodhë. Kjo do të vijë ose përmes Gjykatës Speciale ose përmes një mekanizmi tjeter. Ne vërtetë duhet të pajtohem, sepse është shumë e rëndësishme që të pajtohem dhe të jetojmë paqen, si dhe të ketë paqe në Ballkan. Mirëpo, pajtimi asnjëherë nuk mund të ndodhë pa u shëruar dhe rehabilituar të gjitha viktimat. Do të fillojë nisma për ta dokumentuar këtë se pse duhet, ngase në kuadër të normave ndërkombëtare, kjo është e domosdoshme dhe është e nevojshme përviktimat. Nuk është as kundër serbëve, as kundër Serbisë e as kundër bashkësise ndërkombëtare. Mirëpo, kjo duhet të ndodhë, sepse ky vend nuk mund të ecë përpëra pa u trajtuar dhe rehabilituar të gjitha viktimat e krimit", theksoi Muja.

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar janë krijuar pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës, në vitin 2015, të amendamentit kushtetues dhe legjislacionit përfunksionalizimin e këtij institucioni gjyqësor.

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar hetojnë krimet e pretenduara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë që nga janari i vitit 1998 e deri në dhjetor të vitit 2000.

Në javën e parë të nëntorit të vitit 2020, Dhomat e Specializuara kanë konfirmuar akuzat ndaj ish-kryetarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hashim Thacit, Kadri Veselit, Rexhep Selmit dhe Jakup Krasniqit, për krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit, duke i ngarkuar ata për "ndërmarrje të përbashkët kriminale".

Më 24 shtator, Salih Mustafa, ish-epror i UÇK-së është arrestuar dhe dërguar në Hagë. Aktakuza e ngarkon atë për kryerjen e krimeve të luftës. Ish-pjesëtarët e UÇK-së, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj janë arrestuar më 25 shtator nga Dhomat e Specializuara të Kosovës, ku më pas u transferuan në gendrën e ndalimit në Hagë.

Gucati dhe Haradinaj akuzohen "për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, përkatësish përfrikësimi të dëshmitarëve, hakmarje dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës". Të gjithë këta të akuzuar, gjinden në paraburgim në Hagë dhe janë deklaruar të pafajshëm.

1 651 testime, nëntë pacientë të vdekur dhe 704 raste të reja me Covid në Kosovë

Në Kosovë situata epidemiologjike vazhdon të mos ketë ndryshime, pasi autoritetet regjistrojnë me qindra raste të infektuarve në baza ditore. Të mëkurën Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShPK) se gjatë 24 orëve të fundit, nga 1 651 mostra të testuara, 704 kanë dalë pozitive me Covid-19. Sipas raportit, gjatë kësaj periudhë janë shënuar edhe nëntë raste të vdekjes

EPOKA ERE Faton Dërmaku

PRISHTINË, 25 NËNTOR- Gjatë 24 orëve të fundit, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), janë testuar gjithsej 1 651 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 704 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar nëntë raste të vdekjes me ketë virus.

Rastet e vdekjes janë nga komunat: Klinë dy raste (84, 72 vjeç), Rahovec dy raste (82, 76 vjeç), Drenas një rast (64 vjeç),

Ferizaj një rast (81 vjeç), Gjakovë një rast (77 vjeç), Suharekë një rast (78 vjeç) dhe Prishtinë një rast (83 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 36 253 raste nga 135 969 persona të dyshimtë me ketë virus dhe 948 raste të vdekjes Gjatë 24 orëve të fundit, janë shëruar 391 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 22 137 raste, kurse numri i rasteve aktive është 13 168.

Rastet pozitive janë nga komuna Prishtinë 271 raste, Pejë 46 raste, Fushë-Kosovë 41 raste, Gjakovë 34 raste, Ferizaj 31 raste, Gjilan 30 raste, Lipjan 29 raste, Podujevë 28 raste, Prizren 27 raste, Mitrovicë 26 raste, Obiliq 17 raste, Suharekë



17 raste, Drenas 15 raste, Malishevë 15 raste, Skenderaj 13 raste, Deçan 10 raste, Vushtrri 8

raste, Klinë 7 raste, Shtime 7 raste, Viti 7 raste, Graçanicë 4 raste, Junik 4 raste, Kamenicë 4

raste, Kaçanik 4 raste, Rahovec 4 raste, Istog 3 raste dhe Dragash 2 raste.

Balaj-Halimaj e Grubi dakordohen për mbledhjen e përbashkët Kosovë-Maqedoni

EPOKA ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 NËNTOR- Zëvendëskryeministrja e Republikës së Kosovës, Albulena Balaj-Halimaj ka pritur të mëkurën në takim zëvendëskryeministrin e parë të Maqedonisë së Veriut, Artan

Grubi, me të cilin ka biseduar për zhvillimet aktuale si dhe situatën pandemike në dy vendet tona.

Pas takimit, zëvendëskryeministrja Balaj-Halimaj dhe zëvendëskryeministri Grubi, kanë mbajtur një konferencë të përbashkët për media, në të cilën theksuan se biseda e tyre ishte e fokusuar në funksion të përgatitjes së mbledhjes së përbashkët të dy qeverive.

Më tej, zëvendëskryeministrja Balaj-Halimaj tha se bashkë me Grubin kanë marrë përsipër organizimin e kësaj mbledhje në të cilën do të nënshkruhen disa marrëveshje në fusha të ndryshme në interes të qytetarëve dhe biznesit. "Angazhimi ynë do të

jetë arritura e një marrëveshje për një pikë të përbashkët kufitare si dhe një studim të fizibilitetit përrugën Prizren-Tetovë. Po ashtu do të ketë marrëveshje tjera në fushën e arsimit, kulturës, rinisë dhe sportit", ka thënë zëvendëskryeministrja Balaj-Halimaj.

Po ashtu, zëvendëskryeministrja Balaj-Halimaj e falën-deroi zëvendëskryeministrin Grubi për gatishmërinë dhe vullnetin e tij në funksion të përgatitjes dhe organizimit sa më të mirë të kësaj mbledhje. Ndërkëq Grubi ka thënë se Qeveria e Maqedonisë së Veriut dhe Qeveria e Kosovës do të realizojnë mbledhje të përbashkët së shpejti, pasi të dy vendet kanë shumë çështje për të diskutuar dhe shumë marrëveshje për të nënshkruar në të mirë të qytetarëve. "Këtë sot e diskutova me zëvendëskryeministren e Qeverisë së Republikës së Kosovës, znj. Albulena Balaj-Halimaj gjatë vizitës time në Prishtinë. Bashkë biseduam



edhe për rëndësinë e interkonekcionit me gaz të Republikës së Zëvendëskryeministres Balaj-Halimaj i përsërita qëndrimin

tim deri në fund të mandatit katërvjeçar të qeverisë, qytetarët e të dyja vendeve do të kenë mundësinë që nga Shkupi në Prishtinë dhe anas-

jelltas të arrijnë për 40 minuta, duke vijuar edhe me krijimin e pikave të përbashkët kufitare midis Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës", ka thënë Grubi.



FLET PËR "EPOKËN E RE" NËNKRYETARI I PARTISË DEMOKRATIKE TË KOSOVËS (PDK), SHAQIR TOTAJ

PDK-ja NUK E KA PRIORITET PËRFSHIRJEN NË QEVERI

Nënkyetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Shaqir Totaj, ka thënë se ky subjekt politik nuk e ka prioritet përfshirjen në qeverinë Hoti. Në këtë intervistë dhienë për gazeten "Epoka e re", ai ka theksuar se PDK-ja do të qëndrojë në opozitë. "PDK-ja nuk e ka prioritet çështjen e hyrjes në qeveri. Ne e respektojmë vendimin e qytetarëve që është dhënë më 7 tetor si dhe deklaratën e kryetarit Veseli, i cili ka thënë se PDK-ja do të qëndrojë në opozitë", është shprehur ai. Totaj ka thënë se zgjedhjet e reja duhet të jenë opsioni i fundit për Kosovën. Ai ka thënë se të gjithë aktorët politikë duhet të kenë një qasje konstruktive për një zgjidhje tjetër para se të mendojnë për zgjedhje të reja

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 25 NËNTOR -
"Epoka e re": Z. Totaj, PDK-ja është duke mohuar përfshirjen në këtë qeveri, ndërkohë ka zëra që do të negocioni për postin e kryeministrat. Cila është e vërteta?

Totaj: PDK-ja për momentin nuk e ka prioritet çështjen e

hyrjes në qeveri. Ne e respektojmë vendimin e qytetarëve që është dhënë më 7 tetor si dhe deklaratën e kryetarit Veseli, i cili ka thënë se PDK-ja do të qëndrojë në opozitë. Zhvillimet që kanë ndodhur më tutje kanë treguar se PDK-ja di të jetë parti opozitore konstruktive. Tani, pas zhvillimeve që kanë ndodhur, asaj të Gjykatës Speciale, ne nuk

e kemi fare prioritet hyrjen në qeveri. Prandaj kjo temë nuk është duke u diskutuar në kryesi të PDK-së. Me këtë temë po merren mediat dhe analistët. Edhe një herë po them se për momentin nuk është temë me të cilin ne jemi fokusuar si subjekt politik.

"Epoka e re": Po nëse vjen puna në mes të hyrjes në qeveri dhe

ofrimit të postit të kryeministrat dhe shkuarjes në zgjedhje, cili do të ishte opzioni optimal për PDK-në?

Totaj: Në politikë është vështirë t'i definosh opsonet sepse ka shumë opsonë dhe shumë variante. Konsideroj se si shoqëri dhe si shtet për momentin zgjedhjet do të duhej t'i lëmë të fundit, në mënyrë që të kërkojmë zgjidhje para se të shkojmë në zgjedhje.

Keni parasysh, jemi në kohë pandemie. Nuk kemi luksin që qytetarët t'i pojme në zgjedhje çdo vit, sepse vitin e kaluar kemi pasur zgjedhje dhe të shkojmë sërisht në zgjedhje është ngarkesë. Gjithashtu, kemi të bëjmë me shpenzime të mjeteve monetare. Prandaj konsideroj se do të duhej të tentojmë të gjejmë një zgjidhje tjetër para se të shkojmë në zgjedhje. Mendoj se me një

qasje konstruktive të gjithë aktorëve politikë, një gjë e tillë është e mundshme.

"Epoka e re": Kemi qëndrime konsistente nga ju dhe nga LVA, po ashtu asnjëra palë nuk po e voton Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike?

Totaj: Besoj se do të mund të gjendet zgjidhja nga kjo situatë. Sa i përket Projektit për Rimëkëmbje Ekonomike, nuk e përashtoj mundësinë që duhet të analizohet në mënyrë më konkrete, pasi qytetarët po e kërkojnë votimin e këtij projektligji. Në PDK e kemi diskutuar këtë dhe kemi pasur propozime. Z. Bedri Hamza i ka dhënë propozimet për një ligj gjithëpërfshirës i cili kap një vlerë prej 320 milionë eurosh, kurse tani kemi një mungesë të fleksibilitetit nga ana e qeverisë për të biseduar, pra që t'i shoh

Përmbyllje e suksesshme e stërvitjes fushore ‘Ujku vigjilent-02’

PRISHTINË, 25 NËNTOR (ER)- Në Poligonin e stërvitjeve taktike në fshatin Cernushë, u realizua stërvitja fushore katërdisiore “Ujku vigjilent-02” me demonstrimin stërvitor përmbyllës të Kompanisë së Mekanizuar të Regjimentit të Tretë të Forcave Tokësore të FSK-së. Për të parë nga afér demonstrimin e operacioneve stërvitore, ishin ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, komandanti i FSK-së, gjeneral-allejtënan Rahman Rama, komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneral brigadë Fadil Hadergjonaj dhe atasheu ushtarak i ShBA-së, major Bret Wisecup. Ata u pritën nga zëvendëskomandanti i Regjimentit të Tretë, major Ilir Beqiri, dhe komandanti i Kompanisë së Mekanizuar, toger Bardhy Dugolli, të cilët njofuan lidhur me konceptin, njësitet e angazhuara, përbërjen e tyre, organizimin, skenarët si dhe kurset e veprimit të cilat u ekzekutuan në stërvitjen përkatëse.

Pas demonstrimit stërvitor, pjesëtarëve të task-forcës pjesëmarrëse në stërvitje iu drejtua ministri i Mbrojtjes, Anton Quni i cili shprehu impresionet e tij për nivelin e lartë të profesionalizimit të demonstruar gjatë stërvitjes. “Ky nivel profesional, kjo shkallë e angazhimit dhe përkushtimit janë faktori determinues i besimit të plotë në ju. Kërcënimet ndaj nesh fare nuk na brengosin sepse fitues është ai që mbron vendin e vet.” tha ndër të tjera ministri Quni. Nga ana e tij, gjeneral Rama shprehu vlerësimin e lartë për shkallën e profesionalizmit të demonstruar duke theksuar se kjo e arritur me standarde bashkëkohore na forcon besimin në qëllimit tonë, integrimin në NATO me forca të ndërveprueshme për operacione të përbashkëta me forcat aleate. “Sa më parë të realizojmë këtë qëllim do të jetë më mirë jo vetëm për vendit tonë por edhe rajonin e më gjjerë” tha ndër të tjera gjener-

al Rama. Pas demonstrimit të operationeve urbane, nga ana e ministrit Quni dhe gjeneral Ramës, u përruua solemnisht, Poligoni i Stërvitjeve për Operacione Urbane të FSK-së. Poligoni përkatës i përrruar sot ka filluar së ndërtuar para një viti dhe plotëson të gjitha kushtet pë trajnim deri në nivel kompanie. Ky moment ishte shumë domethënës pasi që ideator për ndërtimin e këtij poligoni ishte nën oficeri i dalluar i FSK-së, tashmë i ndjerë, kapter Baki Ejupi. Stërvitja fushore “Ujku vigjilent” shënon edhe përfundimin e ciklit të trajnimit tremujor të kompanisë përkatëse me mbështetjen edhe të AIR MEDEVAC të Ushtrisë Amerikane. Ky është aktiviteti i radhës i Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së në kuadër të procesit të zhvillimit të aftësive dhe kapaciteteve operacionale për mbrojtjen e territorit, si detyrim kryesor ligjor i saj.



sugjerimet dhe rekondimet tona. Tek atëherë ne mund t'i jemi të gatshëm ta votojmë këtë projektligj.

“Epoka e re”: Mbështetjet e PDK-së gjendet në Hagë dhe, sipas njohësve të çështjeve juridike, ky proces mund të zgjasë deri në dhjetë vjet, sa është e modifikuar PDK-ja në këtë situatë?

Totaj: Nuk besoj se ky proces do të zgjasë kaq. Jam i sigurt se z. Veseli do të kthehet i pafajshëm, sepse Ushtria Çlirimtare nuk mund të dënonhet. Sa i përket momentumit tjetër, mendoj se jemi të gatshëm që këtë sfidë ta shndërrojmë në energji. PDK-ja nga kjo sfidë do të dalë akoma më e fortë dhe më e unifikuar dhe më e përgjegjishme karshi sfidave që na presin. Të gjithë ata që presin se PDK-ja do të dorëzohet dhe do ta ngrehë flamin e bardhë, e kanë gabim. Zhvillimet e ardhshme do të dëshmojnë se cila është forca e PDK-së. Në Podujevë ndoshta do ta jepim mesazhin e parë që PDK-ja nga të gjitha këto sfida do të dalë më e fortë.

“Epoka e re”: Në qarqe të nivelit lokal sa jeni duke punuar, meqë tash Enver Hoxhaj është ushtrues detyre i kryetarit?

Totaj: Z. Hoxhaj është ushtrues detyre i kryetarit të PDK-së. Në këtë drejtim i ka të gjitha kompetencat dhe përkrahjen nga të gjitha strukturat e PDK-së, përfshirë këtu edhe strukturën e ngushtë. Besoj se sa i përket funksionimit nuk do të kemi ndonjë pengesë. Hoxhajt i është dhënë detyrë e rëndësishme dhe është person i dëshmuar. Besoj se PDK-në do ta udhëheqë në mënyrën më të mirë të mundshme. Po ritheksoj se të gjitha këto sfida do t'i shndërrojmë në energji të re. Ka pasur shumë kritika në adresë të PDK-së dhe tani po vërehet mungesa e PDK-së. Po shihet se pa PDK-në në qeveri nuk ka vendime të mëdha dhe nuk ka lëvizje në proceset e mëdha.

“Epoka e re”: Nëse vendi shkon në zgjedhje, sa jeni të përgatitur si parti?

Totaj: PDK-ja çdoherë është e gatshme, mirëpo ne marrim vendime racionale dhe tentojmë të bëjmë selektimin e metodave dhe të mjeteve që tentojmë t'i aplikojmë për ta dhënë kontributin tonë. Besoj se PDK-ja do të ketë rritje.

“Epoka e re”: Në qarqe të nivelit lokal sa jeni duke punuar, meqë tash Enver Hoxhaj është

kryetarit Haskuka në Prizren?

Totaj: Jo që ka dështuar në qeverisjen lokale, por është koritur. Kur e them këtë kam shumë argumente. Po ju përmend vetëm një që lidhet me natyrën e profesionit tim. Vetëm në vitin 2020 nga investimet kapitale, Komuna e Prizrenit i ka 13 milionë euro suficit buxhetor, që është 60 për qind e totalit të mjeteve të ndara për investime kapitale. Në tre vjetët e fundit kemi suficit prej 19 milionë eurosh. Nëse kësaj ia shtojmë shumën

prej 5 milionë eurosh e gjysmë që i ka humbur Komuna e Prizrenit për shkak të mosvotimit të buxhetit të vitit 2021, mbërrimë te shuma prej 25 milionësh, para që janë larguar nga qarkullimi. Ky është një dëm i madh që i është shkaktuar ekonomisë së Prizrenit. Të bëjmë një matematikë të thjeshtë, 25 milionë euro janë 25 projekte me nga 1 milion apo 250 projekte me ka 100 mijë euro. Pra është një humbje e madhe kur kësaj ia shtojmë investimet

në DKA, në shëndetësi si dhe në keqmenaxhim të qendrës kulturore historike. Pres që në vitin e ardhshëm, në zgjedhjet lokale, LV-ja përfundimisht do të largohet nga pushteti. Ndoshja ka qenë një e mirë që ka ardhur në pushtet dhe ka treguar se sa vlen dhe është mirë që edhe komunat e tjera t'i marrin këto informacione dhe në zgjedhjet e ardhshme lokale, ta eliminojnë si opsjon LV-në, pasi është parti e axhamive. LV-ja nuk ka kuadro. Krejt çfarë sheh, është sot për nesër!

Ferid Agani propozohet për president

PRISHTINË, 25 NËNTOR (ER)- Dega e Partisë së Drejtësisë në Gjilan ka propozuar kryetarin e kësaj partie, Ferid Agani për president të Kosovës. Me këtë rast, kjo degë ka vlerësuar se Agani ka potencial për ta ushtruar detyrën e presidentit. "Prof. dr. Ferid Agani, një personalitet i njojur, që

rrjedh nga një familje patriotike, me potencialin e tij propozohet kandidat për pozitën e presidentit për pesë vitet e ardhshme nga ana e PD-së, Dega në Gjilan, dhe ky propozim i bëhet në mënyrë publike subjekteve të koalicionit, por edhe opinionit publik. Kriza ekonomike si

pasojë e pandemisë, por edhe ajo politike sidomos kur është fjalë për pozitën e Presidentit, do të gjenerojnë probleme sociale, politike, ekonomike dhe ato do të janë aktive edhe për një kohë të gjatë", është thënë në njoftimin e Degës së PD-së në Gjilan.



KPK, FOL, Internews Kosova dhe Debate Center nënshkruan memorandum mirëkuptimi



PRISHTINË, 25 NËNTOR (ER)- Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), Fol, Internews Kosova dhe Debate Center të mërkurën kanë nënshkruar memorandum mirëkuptimi. Ky memorandum u nënshkrua me qëllim të zbatimit të projektit "Sistemi i Drejtësisë në Kosovë i Përgjegjshëm, i Besueshëm dhe Transparent", i cili është finansuar nga INL (Byroja e Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit) dhe do të zbatohet nga Fol, Internews

Kosova dhe Debate Center. Qëllimi i këtij memorandumi është të përcaktojë veprimet e përbashkëta ndërmjet KPK-së dhe FOL, Internews Kosova dhe Debate Center për zbatimin e projektit i cili ka për qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënes në Sistemin Drejtësisë në Kosovë. Memorandumi ka paraparë shumë aktivitete që duhet ndërmarrë nga palët nënshkruuese me qëllim të realizimit të projektit të

lartcekur. Ky memorandum është në vazhdën e aktiviteteve të Këshillit Prokurorial të Kosovës për ngritjen dhe fuqizimin e komunikimit dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile. Kryesuesi i KPK-së, Bahri Hyseni, pas nënshkrimit të memorandumit tha se institucioni që ai kryeson e vlerëson kontributin e shoqërisë civile në fushën e sundimit të ligjit dhe mbeten përherë të gatshëm përfqizim të bashkëpunimit.

Nënshkruhet deklarata kundër ngacmimit seksual në administratën publike



PRISHTINË, 25 NËNTOR (ER)- Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti ka nënshkruar të mërkurën deklaratën kundër ngacmimit seksual në administratën publike të Republikës së Kosovës. Me këtë rast ai ka theksuar se, Qeveria e Republikës se Kosovës mbetet e përkushtuar për zbatimin e politikave aktive në fushën e të drejtave të njeriut, mbrojtjen nga diskriminimi dhe krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët në Republikën e Kosovës. "Bazuar në parimin e mbrojtjes nga diskriminimi dhe me qëllim të zhvillimit të një ambienti të punës të sigurt, të paanshëm, profesional dhe të përgjegjshëm në institucionet e Republikës së Kosovës, sot

miratojmë Politikën kundër ngacmimit seksual në organet e administratës publike të Republikës së Kosovës", ka thënë Hoti. Kryeministrit Hoti ka nënizuar se me këtë deklaratë mbrohet barazia në mes të gjinive si vlerë themelore e zhvillimit demokratik të shoqërisë së Kosovës, përmes ndalimit të çdo veprimi apo sjelljeje që çojnë në cenim të dinjitetit personal të secilit të punësuar në organet e administratës publike. Kryeministri Hoti ka kërkuar nga organet e administratës publike në Republikën e Kosovës që të promovojnë dhe shpërndajnë këtë politikë si dhe të ndërmarrin hapa konkretë për zbatimin e saj.

Osmani e Daka flasin për përgatitjet e zgjedhjeve në Podujevë dhe në Mitrovicë të Veriut

PRISHTINË, 25 NËNTOR (ER)- Me qëllim të bashkërendimit për zgjedhjet në Podujevë dhe në Mitrovicë të Veriut, u.d. presidentja Vjosa Osmani-Sadriu ka mbajtur një takim virtual me kryetaren e KQZ-së, Valdete Daka.

U.d. presidentja Osmani-Sadriu ka ofruar përkrahjen e saj të plotë, në mënyrë që zgjedhjet në këto dy komuna të organizohen duke mbrojtur shëndetin e qytetarëve si dhe të drejtën e tyre kushtetuese përf

zgjedhur dhe për t'u zgjedhur. Ndërsa Daka e ka njoftuar presidenten Osmani se janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme, si për zbatimin e manualit për mbrojtje nga pandemia, ashtu edhe për zgjedhje të drejta në përputhje të plotë me praktikat demokratike.

Ajo e siguroi presidenten se deri tani nuk kanë hasur në asnjë problem dhe se janë në koordinim të plotë me institucionet përgjegjëse që të

jenë të pajisur me të gjitha materialet e nevojshme. Në këtë kontekst, u.d. presidentja Osmani-Sadriu bëri thirrje që si personeli zgjedhor, ashtu edhe të gjithë qytetarët, t'i respektojnë masat për mbrojtje nga pandemia, duke mbajtur higjienën, maskën dhe distancën.

Ajo ka ritheksuar rëndësinë e realizimit të së drejtës kushtetuese përf të votuar përf qytetarët e këtyre dy komunave.



Vjosa Osmani-Sadriu

u.d. Presidente dhe Kryetare e Kuvendit të Republikës së Kosovës



Valdete Daka

Kryetare e KQZ-së

Lansohet projekti 'Heras Plus' që synon mbështetjen e arsimit të lartë në Kosovë

Projekti "Heras Plus" synon që brenda tri viteve (2020-2023) të mbështesë zhvillimin e arsimit të lartë dhe hulumtimit shkencor, si dhe zhvillimin shkencave të aplikuara në Kosovë në harmoni me standartet evropiane siç janë ato të Zonës Evropiane e Arsimit të Lartë (EHEA) dhe Zonës Evropiane të Hulumtimeve Shkencore (ERA)

**EPOKA
ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 NËNTOR- Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASh) në bashkëpunim me Agjencinë Austriake për Zhvillim (ADA), nën përkujdesje të ambasadorit austriak në Kosovë, Christoph Weidinger, dhe ministrit të MASh-it, Ramë Likaj, kanë bërë lansimin zyrtar të projektit "Heras Plus".

Për shkak të kushteve të krijuara nga pandemia Covid-19, si dhe në përputhje me udhëzimet e IKShPK-së, konferenca lansuese e projektit u zhvillua e tëra në platformë virtuale (online).

Projekti "Heras Plus" është bashkëfinancim i Agjencisë Austriake për Zhvillim dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Projekti synon që brenda tri viteve (2020-2023) të mbështesë zhvillimin e arsimit të lartë dhe hulumtimit shkencor, si dhe zhvillimin shkencave të aplikuara në Kosovë në harmoni me standartet evropiane siç janë ato të Zonës Evropiane e Arsimit të Lartë (EHEA) dhe Zonës Evropiane të Hulumtimeve Shkencore (ERA).

Ministri i Arsimit, Ramë Likaj, në fjalën e tij, ka theksuar se Ministria e Arsimit dhe Shkencës

është e përkushtuar të bashkëpunojë ngushtë me të gjithë donatorët ndërkombëtarë të specializuar në fushën e arsimit dhe shkencës, e në veçanti me donatorët nga Republika e Austrisë. Gjithashtu, ai konstatoi se projekti i përbashkët "Heras Plus", është një platformë ideale përmes së cilës mund të jetësohen ndërhyrjet e nevojshme zhvillimore në sistemin e arsimit të lartë, hulumtimit shkencor dhe shkencave të aplikuara, duke përfituar nga praktikat më të mira austriake në këtë fushë. Në anën tjetër, ambasadori

austriak në Kosovë, Christoph Weidinger, ka theksuar se Austria është donatori dëshirues i kryesor i Kosovës në fushën e arsimit të lartë.


Në vijim, ambasadori austriak vlerësoi se të rinjtë janë pasuria kryesore e Kosovës, prandaj, investimi në arsim është një investim i sigurt në të rinjtë e Kosovës.

Ambasadori Weidinger ka nënizuar se së bashku me MASh-in kanë punuar dhe po punojnë të zbatojnë reformat e nevojshme që ta bëjnë sistemin e arsimit në Kosovë më modern, më konkurrues dhe më funksional, si dhe për ta harmonizuar atë me standartet evropiane.

Ai vlerësoi se projekti "Heras Plus", është një mekanizëm i përshtatshëm për të arritur këto synime. Gjatë konferencës u konstatua se arsimi i lartë,

hulumtimi shkencor dëshirues i aplikuara paraqesin fusha me rëndësi për MASh-in. Këto fusha në mënyrë të drejtpërdrejtë reflektojnë në zhvillimin dhe ecjen e përgjithshme të Kosovës si shtet drejt familjes së shteteve evropiane, si dhe ecjen e shoqërisë dëshirues i ekonomisë kosovare drejt shoqërisë dëshirues i ekonomisë evropiane.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës e ka vlerësuar lartë mbështetjen e ofruar nga Austria, përfshirë fondet e ndara nga ADA, si dhe ekspertizën dëshirues i asistencë teknike të ofruar nga tri organizatat e specializuara Austriake, WUS Austria, ZSI dhe OeAD, të cilat bashkërisht e implementojnë projekthin "Heras Plus". MASh-i është angazhuar si bashkëfinancues i projektit, i cili ka vlerën 2.8 milionë euro.



Kryeministri Hoti: Dhuna ndaj gruas duhet të çrrënjoset

PRISHTINË, 25 NËNTOR (ER)- Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka hapur fushatën e 16 ditëve të aktivizmit global me moton "Financo, Përgjigju, Parandalo dhe Mbledh të dhëna", ku theksoi se dhuna ndaj gruas duhet të çrrënjoset pa asnjë përjashtim, sepse përveç se është shkelje e të drejtave njerëzore, është problem shoqëror. Hoti foli edhe për diferençat e mëdha gjinore në tregun e punës në vend, duke theksuar se deri në katër herë meshkujt janë më të privilegjuar, më të përfaqësuar në

tregun e punës se sa gratë. Duke folur për ndikimin e pandemisë Covid-19 në zhvillimin ekonomik, me theks në ndërmarrjet që menaxhohen nga gratë, kryeministri Hoti tha se sot përmbylljet një cikël i aktiviteteve në kuadër të masës së 10-të, për mbështetje financiare për gratë në biznes me 2 milionë euro, prej të cilave 1 milion ndahen menjëherë dhe 1 milion deri në fund të këtij viti. Kryeministri Hoti u zotua se Qeveria e Republikës së Kosovës do t'i kryej të gjithë obligimet

ligjore dhe institucionale për parandalimin e dhunës ndaj grave, si kauzën më fisnikë të shoqërisë. "Të gjitha studimet që ekzistojnë për rëndësinë e barazisë gjinore tregojnë që për aq kohë sa shoqëritë nuk janë të barabarta, përvèç se është shkelje e të drejtave njerëzore, është problem edhe shoqëror edhe ekonomik, sepse gjysma e potencialit ekonomik, social, etj. nuk është vënë në funksion të zhvillimit të shoqërisë, prandaj duhet të gjithë të angazhohemi në këtë drejtim", ka thënë Hoti.



Dumoshi: Biblioteka Kombëtare, tempull i dijes ku kanë kaluar gjenerata intelektualësh

Biblioteka Kombëtar e Kosovës ka mbushur 76 vjet prej kur se është themeluar. Me ketë rast, në hapësirat e objektit të saj është organizuar një ceremoni festive, në bashkëpunim të BKK-së me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka thënë se Biblioteka Kombëtare është tempull i dijes ku kanë kaluar gjenerata intelektualësh



EPOKA ERE Qendresa RAMA

PRISSHINË, 25 NËNTOR- Biblioteka Kombëtar e Kosovës ka mbushur 76 vjet prej kur se është themeluar. Për shenimin e ditëlindjes së Bibliotekës, në hapësirat e objektit të saj është organizuar një ceremoni festive, në bashkëpunim të BKK-së me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Në kuadër të ceremonisë u nënshkrua plani pesëvjeçar i ardhshëm i BKK-së dhe nga drejtori i Bibliotekës, Fazli Gajraku u prezantua historiku i punës së institucionit si dhe u organizuan edhe dy ekspozita

për ndër dë kujtim të profesor Anton Çettës, shkrimitarit, patriotit, mbledhësit të folklorit dhe pajtuesit të gjaqeve.

Të pranishmit patën rastin që të shohin eksposítën "Anton Çetta: 100-vjetori i lindjes" me libra dhe artikuj të/për Anton Çettën në koleksionet e BKK-së.

Po ashtu, edhe eksposítën e fotografisë: "Anton Çetta: 30-vjetori i pajtimit të gjaqeve" ku u paraqiten fotografi të publikuara për herë të parë për publikun e gjërë. Në këtë ceremoni mori pjesë edhe ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, rektori i Universitetit të Prishtinës, Naser Sahiti, kryesuesi i Këshillit

Drejtues të BKK-së, Osman Gashi dhe shumë personalitete tjera.

Ministrja Dumoshi tha se sot është një datë e shënuar jo vetëm për BKK-në, sepse nëpërmjet kësaj dite po kujtohen gjithë brezat që kanë dhënë mundin e dijen për këtë institucion të rëndësishëm shtetëror që prej vitit 1944. "Sot gjendemi në një vend të veçantë, në Bibliotekën

Kombëtare, 'Pjetër Bodgani', ky vend është tempull i dijes, ku kanë studiuar gjenerata të tëra intelektualësh të mëhershëm dhe të sotëm, të profileve e fushave të ndryshme të shkencës, kulturës dhe artit", u shpreh ministria Dumoshi, e cila tregoi edhe përritjen e buxhetit të Këshillit të Librit për botimin dhe pasurimin e sa më shumë tituve të librave të rindj, e që ndërlidhet drejtësëdrejti me punën që Biblioteka bën.

Ministrja Dumoshi, tha se për shkak të pandemisë, kontakti i lexuesit me librin e bibliotekën ka qenë pothuajse i pamundur, prandaj i është dhënë përparrësi digitalizimit të materialeve dhe fondit bibliotekar ashtu që lexuesi të ketë qasje në materiale të digitalizuara.

Gjithashtu ministria foli edhe përmuaqin e Anton Çettës, që për ndër të figurës së tij, Qeveria e Kosovës, muajin nëntor e ka shpallur Muaji i Anton Çettës. "Biblioteka e Kosovës po organizon sot aktivitete përkëtë figurë të madhe të kombit shqiptar, i njohur për ndikimin e tij si mbledhës i folklorit, përkthyes, shkrimitar, e si

veprimtar e prijatar i pajtimit gjatë viteve 90-të", ka thënë Dumoshi.

Drejtori i BKK-së, Fazli Gajraku, foli për të ardhmen dhe objektivat që ka Biblioteka në të ardhmen, ndonëse ky vit ka qenë shumë i vështirë, vlerësoi ai. "Në kuadër të bibliotekës digitale tashmë kemi mijëra materiale digitale dhe është duke u vazhduar digitalizimi i njësive fizike duke e pasuruar kështu arkivin digital", sqaroi drejtori kur foli për procesin e digitalizimit të materialeve në bibliotekë.

Osman Gashi kryesues i Këshillit Drejtues të Bibliotekës Kombëtare, foli për punën e këshillit dhe bashkëpunimin me menaxhmentin e BKK-së dhe ka shtuar se biblioteka ka mbijetuar njëjtë ashtu siç ka mbijetuar Kosova, duke kujtuar dhe vlerësuar rëndësinë që ka luajtur ky institucion i kulturës në Kosovë.

Ndërsa, rektori i UP-së, Naser Sahiti ka thënë se UP-ja dhe BKK-ja kanë një bashkëpunimi të ngushtë i cili është jetik për institucionet e arsimit të lartë.



UNDP dhe UNV mbështesin Kuvendin me mjete digitale përmbytjen e takimeve virtuale

PRISSHINË, 25 NËNTOR (ER)- Pandemia Covid-19 ka sjellë një valë të re të transformimit digital, duke rritur nevojën për transferim të shpejtë në teknologjitet digitale.

Institucionet në mbarë botën vazhdimisht po u drejtohen zgjidhjeve digitale përmbytjen e operacionet përditshme. Distancimi fizik si një nga masat parandaluese përmbytjen e pandemisë, së bashku me kapacitetin e kufizuar teknik po sfidojnë aftësinë e institacioneve përmbytjen e kryer plotësisht detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.

Edhe institucionet e Kosovës janë drejta teknologjive digitale në mënyrë që të provojnë të kontrollojnë përmbytjen e virusit. Përkundër

pandemisë, Kuvendi i Kosovës duhet të vazhdojë të ushtrojë mandatin e tij legjislativ edhe pse në rrëthana shumë të vështira.

Pikërisht përmbytjet e arsyesh Programi i Kombeve të Bashkuara përmbyt zhvillim (UNDP) dhe Zyra e Vullnetarëve të Kombeve të Bashkuara (UNV) kontribuan në forcimin e infrastrukturës digitale të Kuvendit të Kosovës duke dhuruar pajisjeve përmbytjen e videokonferencave (licencën e Zoom dhe CISCO Webex).

Mbështetja me këto mjete do të mundësohen takime dhe iniciativa të tjera virtuale, në mënyrë që Kuvendi i Kosovës të vijojë funksionet administrative dhe të vazhdojë ti mbajt përmbytjen e informuar qytetarët.

Maria Suokko, përfaqësuese e përhershme e UNDP, vuri në dukje rëndësinë e teknologjisë digitale në kohë të pandemisë. "Transformimi digital ka kaluar nga të qenit një opsjon në një prioritet. Shpresojmë që dhurimi i këtyre mjeteve digitale të ndihmojë Kuvendin e Kosovës në këtë rrugëtim digital dhe të forcojë kapacitetet e tij", ka thënë ajo.

Arberie Nagevci, nënëkryetare e Kuvendit të Kosovës, në fjalën e saj falënderoi UNDP dhe UNV përmbytjet e tyre gjatë pandemisë. "Mjetet digitale do të kenë një rëndësi të madhe në forcimin e infrastrukturës digitale të Kuvendit dhe do të na mundësojë të mbajmë takime virtuale përfshirë takimet e presidencës, sfida me të cilat



jemi përballur që nga fillimi i pandemisë", është shprehur ajo. Ky kontribut u financa nga "The UN Covid-19 Response and Recovery Multi-Partner Trust Fund (Covid-19 MPTF)", i

lansuar nga sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, përmbytjet e tejkalimin e krizës shëndetësore dhe zhvillimore të shkaktuara nga pandemia Covid-19.

Milionat që nuk sollën dritë



PRISHTINË, 25 NËNTOR- Nga 300 milionë euro sa ishte premtuar se do të investoheshin nga konsorciumi turk Çalık-Limak për distribuimin e furnizimit me energji elektrike, deri më tani janë investuar mbi 150 milionë euro, ka bërë të ditur zëdhënësi i Distribucionit të Furnizimit me Energji Elektrike (KEDS), Viktor Buzhala. Ky konsorcium, i cili në vitin 2012 privatizoi rrjetin kosovar të shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike, duke e blerë atë për 26.3 milionë euro, kishte premtuar se për 15 vjetët e ardhshëm do të bëjë investime në rrjet, furnizim stabil të energjisë elektrike dhe zgjedhje humbjeve komerciale dhe teknike.

Por, këto investime kanë treguar që janë të pamjaftueshme për të siguruar furnizim stabil me energji elektrike, pasi që Kosova vazhdon të përballet me ndërprerje të kohëpaskohshme të energjisë elektrike.

KEDS/KESCO në bazë të licencës dhe kontratave me konsumatorët, ka për obligim furnizimin e pandërprerë me energji elektrike, pavarësisht sa janë kapacitetet prodhuese të Korporatës Energetike të Kosovës (KEK).

Zëdhënësi i Distribucionit të Furnizimit me Energji Elektrike, Viktor Buzhala, i ka thënë "Radios

Evropa e Lirë" se ndërprerjet e energjisë janë si rezultat i renovimeve të cilat po ndodhin në rrjetin energjetik.

Ai thotë se këto ndërprerje janë të planifikuar dhe konsumatorët njoftohen me kohë. "Në këto raste kur jemi duke bërë renovimin komplet të rrjetit dhe duke i zëvendësuar gjitha astet e rrjetit distributiv të tensionit të mesëm, këto nuk mund të kryhen nën tension dhe si rjedhojë brenda ditës ne kemi bërë ndalesa të planifikuar, këto ndalesa nuk janë të shpeshta", thotë ai.

Së fundmi në Prishtinë banorët e lagies 'Kodra e Diellit', 'Mati 1' dhe disa lagje të tjera për orë të tëra janë ballafaqur me mungesë të energjisë elektrike. Gjatë vikendit të kaluar, banorët e këtyre lagjeve nuk kanë pasur rrymë gati 20 orë. KEDS këtë ndërprerje e kishte arsyetur me një prishje që kishte ndodhur në një nënstacion.

Por, edhe për ditët në vijim, KEDS përmes faqes zyrtare, njofton për ndërprerje të energjisë, për shkak siç thuhet, 'punimeve të domosdoshme që do të bëhen'.

Për këtë vit, shton Buzhala një pjesë e madhe e renovimeve në rrjetin përfunduar, për të filluar përsëri në pranverën e vitit të ardhshëm. "Kemi trashëguar një rrjet energetik në gjendje të rëndë kur është marrë në vitin 2013.

Nevojitet renovim komplet dhe këtë jemi duke e bërë etapa - etapa. Renovimi emergjent do të marrë edhe disa vite kohë", thotë Buzhala.

Ndërprerjet e kohëpaskohshme me energji elektrike kanë vështirësuar jetën e Arditë Simincës dhe familjes së saj pesë anëtarëshe.

Tani në kohën e pandemisë me Covid-19 kur në të shumtën e rasteve puna po bëhet nga shtëpia, dhe fëmijët po ndjekin mësimet online, një ndërprerje e energjisë elektrike, thotë ajo, krijon probleme të shumta. "Kjo çka po ndodh me rrymë, farë nuk është në rregull. Ne e paguajmë energjinë elektrike dhe ta ndalin dhe askujt nuk i intereson, as dëmshpërbirim nuk merr për këtë, ndërsa nëse një muaj nuk e paguan vinë dhe të shkyqin nga rrejti". "Tash të gjitha punët po bëhen nga shtëpia, fëmijët po mësojnë online, ndalet rryma dhe ata e humbin mësimin. Kjo është problem i madh, vetëm pas luftës edhe tani kjo situatë me energji", thotë ajo.

Dardan Abazi, hulumtues i lartë në Institutin për Politika Zhvillimore (INDP), thotë për "Radion Evropa e Lirë" se Kosova ka shitur distribucionin për energji elektrike pikërisht me

arsyen që të mos ketë reduktime. "Operatori e ka një obligim që qytetarët t'i furnizojë pa ndërprerje me energji elektrike dhe kjo nuk po respektohet", thotë ai.

Abazi thotë që Kosova të zgjidhë problemin me energji elektrike duhet të ketë një vendimmarrje më të përgjegjshme, e atillë që është e bazuar në të dhëna, në hulumtime e studime. "Duhet të punohet ne eficiencën e energjisë të bëjmë kursime të energjisë. Kur të optimozojmë në masën sa me të madhe pjesën e eficenës së energjisë, atëherë mund të shikojmë investime në energji elektrike solare, nga era e të tjera. Po ashtu duhet të bëhet edhe integrimi i Kosovës në tregjet rajonale dhe evropiane. Kjo duhet të fillojë me një bashkim të plotë të tregut të Kosovës dhe Shqipërisë një liberalizim të tregut të brendshëm që do të sillet më tepër investime në sektorin e energjisë", thotë ai.

Problemi me furnizim stabil me energji elektrike në Kosovë së fundi është theksuar edhe në raportin e Departamentit amerikan të Shtetit për Klimën e Investimeve të publikuar më 9 shtator të këtij viti.

Kosova tani e sa vite ka një projekt për ndërtimin e termocentralit të ri "Kosova e Re" me kapacitet 500

megavatë, projekt ky i cili ishte konsideruar se do ta shkarkonte Kosovën nga problemet me energji elektrike.

Termocentrali "Kosova e Re" ishte paraparë të fillojë së ndërtuar këtë vit, ndërsa të vihet në punë në vitin 2023 dhe ndërtimi i tij do të kushtonte 1.3 miliard euro.

Por, kompania amerikane Contour Global, e cila ishte përzgjedhur nga qeveria për ndërtimin e termocentralit, është tërhequr tanimë nga plani për ndërtimin e termocentralit.

Qeveria e Kosovës ka thënë se pavarësisht tërheqjes së kompanisë amerikane Contour Global nga ndërtimi i termocentralit "Kosova e Re", Kosova nuk kanë hequr dorë nga realizmi i këtij projekti, i cili synon të shkarkojë Kosovën nga problemet që ka me furnizim stabil me energji elektrike. "Sikur është në programin qeverisës 2020-2023, qeveria do të rishkojë projektin e termocentralit "Kosova e Re". Këto janë modalitetë që po diskutohen në secilin instancë dhe për secilin vendim që merret do të jemi transparentë me publikun dhe do të ju informojmë", pati thënë për "Radion Evropa e Lirë", Uran Haxha, zëdhënës në Ministrinë e Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Hoti: Fuqizimi ekonomik krijon mundësi të barabarta

PRISHTINË, 25 NËNTOR (ER)- Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka pritur të mërkurën në takimin përfaqësueset e Grupit të Grave Deputete të Kosovës, Vlora Limani-Hajnuni, Teuta Haxhiu dhe Besa Ismaili, me të cilat ka biseduar për respektimin e të drejtave të grave në shoqërinë tonë.

Kryeministri Hoti ka nën vizuar rëndësinë për mbështetjen ekonomike të grave në biznes, duke theksuar se fuqizimi

ekonomik dhe pavarësia financiare e grave është njëra ndër format konkrete të mbështetjes afatgjate për krijimin e mundësive të barabarta dhe realizimin e barazisë së plotë gjinore.

Përfaqësueset e Grupit të Grave Deputete të Kosovës para kryeministrit Hoti kanë ngritur shqetësimet që kanë të bëjnë me respektimin e të drejtave të grave, parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe

plotësimin e legjislacionit në mbështetje të realizimit të barazisë gjinore.

Kryeministri Hoti, është zotuar se Qeveria e Kosovës do të vazhdojë angazhimin konkret në përditësimin, plotësimin dhe miratimin e legjislacionit të nevojshëm për të parandaluar dhe evitar dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave, si dhe për të fuqizuar shërbimet sociale, rehabilitimin dhe risocializimin e të gjitha viktimateve të dhunës.



Inspektohen punimet në tri projekte në Kijevë të Malishevës

MALISHEVË, 25 NËNTOR (ER)- Në fshatin Kijevë të Komunës së Malishevës, janë duke u realizuar tri projekte në të njëjtën kohë, ku po ndërtohet një çerdhe dhe dy fusha të sportit për shkollën e mesme dhe shkollën fillore. Punimet në këto tri projekte i kanë inspektuar drejtori Komunal për Urbanizëm, Ahmet Morina dhe shefi i njësisë së prokurimit, Nuhi Shala, për të parë nga afér ecurinë e punimeve sipas planifikimit. Morina e Shala, gjatë inspektimit ishin të shoqëruar

edhe nga anëtari i Kuvendit të Komunës nga Kijeva, Kajtaz Gashi

Drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Ahmet Morina, pasi i ka inspektuar punimet në tri projektet, është ndarë i kënaqur me ecurinë e punimeve dhe ka thënë se çdo punë është brenda planifikimit. "Ndërtimi i çerdhes është duke shkuar shumë më shpejt se planifikimi, ndërsa dy fushat janë brenda planifikimit dhe pritet të përfundojnë brenda pak ditëve, e po ashtu edhe cilësia punimeve është e mirë



dhe sipas standardeve të kërkuar, ka thënë Morina.

Ndërtimi i çerdhes në Kijevë dhe

ndërtimi i dy fushave të sportit për shkollën e mesme profesionale dhe shkollën fillore,

janë projekte të cilat janë mundësuar nga buxheti i Komunës së Malishevës.

Rinovohet paralelja e ndarë e shkollës 'Ganimete Tërbeshi' në Muhoc



FERIZAJ, 25 NËNTOR (ER)- Investimet në përmirësimin e infrastrukturës shkollore po vazhdojnë me intensitet të shtuar në Komunën e Ferizajt. Së fundmi, është paralelja e ndarë e Shkollës Filllore "Ganimete Tërbeshi" në fshatin Muhoc që i është nënshtuar transformimit rrënjesor në

pamjen e jashtme të objektit si dhe rregullimin e oborrit. Pamjet e deri pak ditëve më parë, ku pamja e jashtme e kësaj ndërtese shkollore e obori i saj ishin tërësisht të dëmtuara e të pamirëmbajtura tashmë kanë marrë pamje të re, me investimin e qeverisë lokale. Drejtori i Drejtorisë së

Arsimit, Afrim Llabjani, ka thënë se ky investim e të tjerat që po ndodhin në objektet shkollore në Ferizaj, po zhvillohen në kuadër të programit për përmirësimin e infrastrukturës shkollore e që si të tilla do të vijojnë edhe në objekte tjera shkollore varësisht nga nevoja.

Monografi për çerdhen Ardhmëria në Drenas

DRENAS, 25 NËNTOR (ER)- Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci ka pritur në takim veteranin e arsimit, autorin Nuredin Ibriqaj. Me këtë rast, autor i Ibriqaj i dhuroi kryetarit Lladrovci librin monografi "Institucioni Parashkollar Ardhmeria". Lladrovci e

përgëzoi për librin, duke i uruar suksese në vazhdim të krijimtarisë dhe e falënderoi për kontributin e tij për arsimin në Drenas. Kjo monografi paraqet punën dhe veprimtarinë e IP Ardhmëria në Drenas që nga themelimi, përkatësisht nga viti 1982 e deri në vitin 2012.



Asfaltohet rruga në lagjen e Shasivarëve në Gjilan

Gjilan, 25 nëntor (ER)- Është asfaltuar rruga në Lagjen e Shasivarëve të Bresalcit të Gjilanit, program ky në të cilin është inkorporuar edhe rrjeti i ujësjellësit, kanalizimi fekal e atmosferik dhe ndriçimi publik.

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i cili ka vizituar nga afér punimet, ka thënë se Lagjja e Shasivarëve po bëhet vendbanim tipik ku mbyllen të gjitha projektit infrastrukturore.

Ai ka theksuar se ky model do të shtrihet në çdo fshat dhe vendbanim të komunës së Gjilanit drejt përmbylljes së nevojave infrastrukturore në parimin e qasjes së barabartë. Haziri ka falënderuar banorët

për durimin që e kanë pasur, derisa konfirmoi se shtrati i lumit është i fundit, i cili është paraparë të zgjidhet në kuadër të kolektorëve të ujërave të zeza.

Në emër të lagjes së Shasivarëve ka folur Haki Uruqi, i cili është person me aftësi të kufizuara, duke e ka falënderuar kryetarin Haziri për mbështetjen në realizimin e projekteve infrastrukturore atje dhe krijimin e qasjes së barabartë për të gjithë.

Në emër të banorëve të Bresalcit ka folur Bardhyll Syla, drejtor i Administratës, i cili ka shprehur mirënjojen për kryetarin e Gjilanit për implementimin e programeve infrastrukturore atje.

Ndryshe, ky projekt kap vlerën e investimeve mbi 50 mijë euro.



Uniteti dhe presidenti konsensual po, nëse kapërcehen egot!



Shkruan: Arben ROGOVA

Pakënaqësitë për situatën politike dhe ekonomike jo të mirë në vend, janë vazhdimisht në rritje. Të gjithë jemi dëshmitarë të kësaj gjendje të rënduar dhe zhgënjyese, si: "Gjykata Speciale", dialogu me Serbinë, ekonomia gjithnjë në rënje, rritja e papunësisë dhe dëshmet e bizneseve si pasojë e Covid-19. Ngarkesat dhe shqetësimet si politike dhe ato ekonomike janë paralele. Aktualitetet rreth kandidaturës së presidentit, seancat parlamentare me probleme, Qeveria e brishtë dhe e

shantazhuar nga Lista Serbe, po bëhen brengë serioze. Të habitë ky qëndrim neglizhent në këtë kohë krize i klasës politike. NATO është në Kosovë, por jemi ne që duhet ta fuqizojmë shtetin tonë! Këto shqetësimë dhe dalja nga kjo situatë sigurisht që kanë zgjidhje. Dhe këto zgjidhje kërkojnë kompromis. Kurse kompromisi nënkupton, së pari Kosova e më pas partia e individi. Pra partitë parlamentare në këto rrëthanë duhet të arrijnë marrëveshjet dhe unitetin për këto dy preokupime, presidenti dhe qeveria! Por cilat do të ishin dy zgjidhjet e arsyeshme, të cilat janë pa pazare, pa zgjedhje të reja dhe pa rrezik pandemik?

Sa i përket presidentit, me rrëthanat që po përballemi, esenciale është që presidenti të jetë konsensual. Për ta përmbrushur këtë kriter, një profil i tillë nevojitet të jetë pa parti. Dhe

profile të tillë të edukuar me programe e standarde perëndimore, mjaftueshmë kemi në Evropë e sidomos përtëj Atlantikut. Aktualiteti kërkon domosdoshmërisht personalitet të pa korruptuar dhe atdhetar të dëshmuar ndër vite. Edhe atëherë kur Kosova e kërkonte, kemi shumë të tillë që u dëshmuani në luftë. Dhanë çdo gjë në luftë dhe pas luftës nuk morën asgjë. Kurse tani këta atdhetarë e bëjnë jetën e tyre si qytetar të suksesshëm në vendet ku jetojnë, duke na prezantuar me suksese të mëdha në fushat e tyre në ato shtete. Përkundër obligimeve të tyre të jetës, këta patriotë janë tepër aktivë dhe shumë të preokupuar me zhvillimet në ndërtimin e fuqizimin e shtetësisë së Kosovës. Gjithnjë duke e ditur se problemet me Serbinë ende nuk kanë përfunduar. Pra një profil i tillë do

të jetë unifikues dhe i pranueshmë për shumicën e partive parlamentare, por edhe për miqtë e Kosovës. Edhe qeveria nëse ka kompromis mund të fuqizohet duke u rindërtuar në formatin gjithëpërfshirës. Të gjitha partitë pushtetin mund ta ndajnë sipas përqindjes së votave, sa deputetë aq pushtet. Kurse jetëgjatësia varet nga kompromiset, mund ta mbajnë deri në fund të mandatit apo të jetë e përkohshme. Përbërja e ministrale mund të jetë më e mira duke i zgjedhur profesionistët nga secila parti; më të suksesshmit, qoftë edhe ish-ministra. Kryeministri mund të zëvendësohet, mund të vazhdojë aktuali, apo të bëhet me rotacion njëvjeçar. Këta hapa do ta fuqizonin unitetin e partive politike, dhe përballë të gjitha sfidave aktuale do të jemi shumë

stabil! Për dalje nga kjo situatë, elitës politike i nevojitet vendosmëri për t'i kapërcyer egot e orekset e veta dhe të militantëve partiak. Thënë më ndryshe, lidershipi i partive në rrëthanat aktuale, nuk duhet assesi të llogarisin në kalkulimet e tyre elektorale, sepse përformimi i mirë i përfaqësuesve të tyre nëpër dikasteret përkatëse, do të rriste simpatinë për partinë përkatëse dhe shtimin e votave. Të gjitha këto kompromise e gatishmëri për shkëputje nga realiteti aktual, varen krejt nga atdhetarizmi e niveli i logjikës shtetërore. Kjo duhet të ndodhë. Shteti i Kosovës është mbi të gjitha.

Nëse nuk ka gatishmëri për shkëputje, i mendoi dy opsione: ose janë primitiv dhe nuk mund të dalin nga egot e interesat personale, ose janë të varur..... e ata e dinë nga kush.

Në Gjakovë nisi fushata '16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore'



GJAKOVË, 25 NËNTOR (ER)- Gjakova është përzgjedhur komuna në të cilën të mëkurën ka nisur fushata "16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore", fushatë e cila organizohet në nivel vendi. Për këtë në Gjakovë kanë qëndruar përfaqësuesit më të lartë të institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare, si pjesë e organizimit të kësaj fushate mes tyre edhe ambasadori i BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, koordinatorja e Zhvillimit e KB-së, Ulrika Richardson, shefja e zyrës së UN Women Vlora Nushi, përfaqësuesja rezidente e UNDP-së Maria Suokko, shefja e Misionit të IOM-it, Anna Rostocka e të

tjerë. Në një pritje të kryetari i komunës së Gjakovës Ardian Gjini ka organizuar për ta, është thënë mes Gjakova është përzgjedhur për fillimin e kësaj fushate, përfaktin se llogaritet si njëra prej komunave më aktive në luftën kundër dhunës në baza gjinore. Shembull për këtë është përmendor edhe "Shtëpia e sigurt", si një shembull i mirë që tashmë është bartur edhe në qytete tjera të Kosovës. Kryetari Gjini bashkë me ambasadorin Szunyog dhe myasfirët tjerë e kanë vizituar edhe Shtëpinë e Sigurt, me ç'rast nga menaxhmenti i këtij institucionit janë njoftuar për punën konkrete që po zhvillohet aty.

Gjilani pranon 175 laptopë nga organizata gjermane GIZ për nxënësit në nevojë


GJILANI, 25 NËNTOR (ER)- Komuna e Gjilanit ka filluar të mëkurën shpërndarjen e 175 laptopëve për nxënësit e shkollës filllore "Thimi Mitko", të cilët kanë nevojë për ndjekjen e programeve online.

Kreu i Gjilanit, Lutfi Haziri, i cili ishte i pranishëm në këtë ngjarje, tha se organizata GIZ është njëri nga partnerët më të mëdhenj të Gjilanit në sektorin e arsimit. "Falënderoj GIZ-in për këtë mbështetje. Faleminderit po ashtu edhe menaxhmentit të

'Thimi Mitko' për punën e madhe që po e bëjnë me mësimdhënësit e nxënësit. Fëmijët përfitues janë kategorë e familjeve që kanë nevojë. Besoj shumë që në Gjilan po vendosim barazi sociale në shkolla, sikurse edhe në investime dhe në jetën tonë shoqërore", ka thënë Haziri. Drejtori i Arsimit, Nazim Gagica, pasi falënderoi organizatën gjermane për mbështetjen e vazduheshme, ka thënë se mësimi në këtë komunë po zhvillohet normalisht, duke

shtuar se Gjilani është komuna që nuk e ka të mbyllur asnjë shkollë deri më tash. Drejtoresha e shkollës "Thimi Mitko", Sevdije Sadiku, tha kjo është një ndihmë e madhe për të gjithë këta nxënës, të cilët nuk kanë mundur t'i ndjekin mësimet online për shkak të mungesës së laptopëve. Në fund, kryetari Haziri njoftoi se po vazhdon të implementohet programi shumë i rëndësishëm Wireles Free, për ta shfrytëzuar të gjithë ata që kanë nevojë.





'Dardanët' përfitore ndaj Sllovakisë

Përgjedhësi Christos Marmarinos dhe kapiteni Drilon Hajrizi janë shfaqur optimist para ndeshjes që Kosova e zhvillon të enjten kundër Sllovakisë. Ata besojnë në fitore edhe në ndeshjen e 28 nëntorit kundër Islandës

EPOKA ERE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll Kosova sonte (e enjte) do të përballet me Sllovaninë në Bratislavë nga ora 19:00, në ndeshjen e vlefshëm përfitore parakualifikimet evropiane për Kupën e Botës 2023. "Dardanët" kanë rezultuar negativë në testin përfitore Covid, derisa të mëkurën kanë zhvilluar dy stërvitjet e fundit. Kosova pas Sllovakisë do të përballet me Islandën, sfidë që do të zhvillohet më 28 nëntor nga ora 16:00. Atmosfera në kampin e Kosovës është shumë e mirë dhe basketbollistët janë të motivuar përfitore dhënë maksimumin në këto dy ndeshje. Përgjedhësi i Kosovës, Christos Marmarinos është

optimist para përballetes me sllovakët, ani pse në ketë ndeshje "dardanët" nuk janë të kompletuar. Marmarinos beson në sukses edhe në ndeshjen kundër Islandës, e cila zhvillohet më 28 nëntor nga ora 16:00. "Do të janë ndeshje të vështira. Në garat ndërkombëtare nuk ka ndeshje të lehta. Nuk presim ndeshje të lehta. Sllovakia ka gjatësi më të madhe se ne, por duhet të adaptohemi dhe të paraqitemi në mënyrën më të mirë të mundshme. Ne kemi mundur Islandën një herë dhe sigurisht se mund ta bëjmë përsëri nëse jemi të fokusuar maksimalisht. Sigurisht se ajo që mund të garantojmë është angazhimi ynë maksimal", ka thënë Marmarinos përfaqen zyrtare të FBK-së. Në linje të njëjtë me përgjedhësin është edhe kapiteni i Kosovës,



Drilon Hajrizi. "Ne do të jepim maksimumin në këto dy sfida pa marrë parasysh se kush do të luaj.

Nëse jepim maksimumin, atëherë mund të kemi rezultate pozitive", ka thënë Hajrizi.

Kosova është lidere e grupit, pasi ka shënuar dy fitore ndaj Islandës dhe Luksemburgut.

Prishtina triumfon në 'Zahir Pajaziti', Trepça '89 mposhti Besën



PRISHTINË, 25 NËNTOR (ER) - Prishtina e ka fituar derbin ndaj Llapit (0-2), kurse Trepça '89 e mposhti Besën (4-2). Llapit e pati rastin më të mirë përfitore kaluar në epërsi, por nga penalltia nuk u tregua i saktë Ahmed Januzi. Në pjesën e dytë, Prishtina shënoi dy gola përfitoren e dytë radhazi. Endrit Krasniqit realizoi në minutën e 75-të dhe Leotrim Kryeziut në fund të ndeshjes përfitoret final 0-2. Pas kësaj ndeshje, Prishtina katërta

me 21 pikë, kurse Llapit vazhdon të jetë në pozitën e parafundit me vetëm 8 pikë. Ndërsa, në Trepça '89 nuk e pati të vështirë t'i marrë maksimumin e pikëve ndaj skuadrës pejane. Berisha dhe Darwishi shënuan nga dy gola përfitoren, kurse Tahiri dhe Da Silva shënuan përfitoren. 89-shi është në pozitën e shtatë me 17 pikë, kurse Besa e fundit me vetëm 6 pikë. Sot (e enjte) zhvillohet ndeshja e fundit përfitore kundër Drenicës.

"Bajram Aliu" takohen Drenica dhe Ballkani.

SUPERLIGA

Llapit - Prishtina	0-2
Trepça '89 - Besa	4-2
Drita - Feronikeli	1-1
Arbëria - Gjilani	1-0

Të enjten takohen:
13:00 Drenica - Ballkani

Besa në raundin e tretë përballet me Boracin, Prishtina me AEK-un

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Kampioni i Kosovës, Besa Famgas do të përballet me Boracin e Banjallukës në raundin e tretë të Kupës Evropiane. Shorti përfitë fazë të garave është tërhequr të mëkurën. Nëndeshja e parë luhet më 12-13 dhjetor në Pejë, kurse e kthimit një javë më vonë në Banjallukë të Bosnjë-Hercegovinës. Besa ka shkëlqyer

në raundin e dytë të Kupës Evropiane, duke shënuar dy fitore të thella ndaj Bosna Visoko, skuadrës tjetër bosnjake. Të dy ndeshjet ishin luajtur në Pejë. Besa Famgas ka pretendime përfitore shkuar përtëj raundit të tretë të Kupës Evropiane. Ndërsa në raundin e tretë të Kupës Evropiane suksesin e kërkon edhe KH Prishtina. Kryeqytetasit e

Kosovës raundin e dytë e kaluan pa lojë, pasi skuadra bullgare, Dobrudja hoqi dorë nga ndeshjet. Në raundin e tretë të Kupës Evropiane, Prishtina përballet me AEK-un e Greqisë. Shorti i tërhequr të mëkurën ka përcaktuar që ndeshja e parë të luhet në Athinë më 12 apo 13 dhjetor, kurse ndeshja e kthimit është një javë më vonë në Prishtinë.



Australian Open mund të shtyhet për dy javë

MELBOURNE, 25 NËNTOR - Grand Slam i Australian Open, i parashikuar të nisë në Melburn më datën 18 janar, mund të shtyhet për dy javë. Lajmin e ka konfirmuar Ministri i Sportit në Shtetin e Victoria (Australi),

Martin Pakula. "Turneu mund të shtyhet maksimumi për 2 javë. Mendoj se kjo është zgjidhja më e mirë edhe pse jo e vtmja që kemi për momentin në tavolinë", ka thënë Pakula. "Këtë vit turneu i Wimbledon u

anulua, ndërsa Roland Garros u shty nga pranvera në vjeshtë. Unë jam i idësë se Australian Open do të ketë një shtyrje të vogël, kjo për shkak të situatës shumë komplekse në botë prej pandemisë", ka shtuar Pakula.

Shkak i shtyrjes janë rregullat anti-Covid 19 që janë vendosur në shtetin e Victoria, që detyron të gjithë të huajt të qëndrojnë dy javë në karantinë pasi vijnë në Australi. Nga ky rregull nuk bënë përashtim as tenistët.



Zbulohen 11 kandidatët për 'The Best FIFA 2020', Lewandowski favoriti kryesor



MUNCHEN, 25 NËNTOR - Iu mohua e drejta për të fituar për herë të parë në karrierë "Topin e Artë" por Robert Lewandowski pritet të fitoj çdo trofe individual në qarkullim pasi sezoni i fundit për të ishte fantastik në çdo aspekt, si në rrafshin personal ashtu dhe me Bayern München. FIFA ka bërë publike listën me 11

kandidatët për çmim "The Best 2020", një listë me emra të famshëm ku mes favoritëve kryesor është pikërisht sulmuesi polak. Cristiano Ronaldo (Juventus), Thiago Alcantara (Bayern /Liverpool), Kevin De Bruyne (Manchester City), Robert Lewandowski (Bayern M.), Sadio Mane (Liverpool), Kylian Mbappe (PSG), Lionel Messi

(Barcelona), Neymar (PSG), Sergio Ramos (Real Madrid), Mohamed Salah (Liverpool), Virgil van Dijk (Liverpool) janë 11 lojtarët e përzgjedhur. Tre finalistët do të bëhen publik më 11 dhjetor ndërsa çmimi final, "The Best FIFA 2020" do të akordohet më 17 dhjetor një ceremoni që do të zhvillohet online për shkak të masave të imponuara nga Covid-19.

Hamilton: Ky është sekreti i suksesit tim

LONDËR, 25 NËNTOR - Piloti Lewis Hamilton është njeriu i momentit në Formula 1. Prej vitesh në këtë sport flitet vetëm për pilotin anglez i cili po vendos rekorde të njëpasnjëshme. Me titullin Botëror që fitoi pak javë më parë, Hamilton barazoi legjendën gjermane Michael Schumacher me 7 tituj të fituar në Formula 1, ndërsa e parakaloi gjermanin përsa i përket garave të fituara, me 35-vjeçarin britanik që kryeson me 94 gara të fituara në total. Në një intervistë përfaqen zyrtare të Formula 1, Hamilton ka treguar çelësat e suksesit të tij. "Është dashur kohë, shumë kohë për t'u bërë ky që jam sot. Nuk ka qenë aspak e thjeshtë të bëhem kaq i aftë, edhe pse talenti nuk më ka munguar kurrë. Sekreti i fitimit të 7 titujve kampionë dhe rrëth 100 garave? Disiplinë e madhe dhe



përpjekje e vazhdueshme dhe sistematike për t'u përmirësuar. Çdo vit shkruaj një shënim për t'i kujtuar vetes gjérat që nuk kam arritur

akoma. Pyes veten 'si mund ta bëj këtë, si mund t'ia dal?'. Kjo është mënyra e vetme për të arritur rezultate të larta", ka thënë Hamilton.

SHKURT

Covidi rendon gjendjen shëndetësore të Skënder Gegës, dërgohet në Turqi

Skuadra e Kukësit ka njoftuar se trajneri i skuadrës, Skënder Gegë ka udhëtuar mëngjesin e sotëm drejt Turqisë, për shkak se gjendja shëndetësore e tij është rënduar ditët e fundit. "Për një trajtim më të specializuar përmushkëritë, Gegë ka udhëtuar drejt Stambollit. Klubi i iron trajnerit shërim të shpejtë dhe rikthim sa më të shpejtë në krye të skuadrës", thuhet në njoftimin e Kukësit.

Ronaldo e dëshiron Navasin në Juventus

Juventusi ka një portier të mirë në radhët e veta, Wojciech Szczesny që ka pasur paraqitje të mira për "Zonjën e Vjetër", por Cristiano Ronaldo i ka sugjeruar Juventusit që të transferoj portierin e PSG-së, Keylor Navas. Ylli portugez ka një miqësi të madhe me Keylor Navas, e vlerëson shumë si portier dhe po tenton të bindë drejtuesit e Juventusit të investojnë te ish-shoku i skuadrës te "Los Blancos", teksha Navas besohet se nuk do ta refuzonte bashkimin me CR7.

Simeone infektohet me Covid-19

Ylli i Cagliarit, Giovanni Simeone ka rezultuar pozitiv me Covid-19. Këtë e ka konfirmuar klubu përmes një komunikatës. "Cagliari njofton se Giovanni Simeone ka dal pozitiv me Covid-19 në testet shëndetësore të kryera. Lojtari u izolua menjëherë në përputhje të rregullave. 'Të gjithë anëtarët e tjerë kanë testuar negativisht dh do vazhdojnë me stërvitjen normale', shkroi klubu në komunikatë. Simeone iu bashkohet listëve të lojtarëve të tjerë të Seria A të prekur nga Covid-19, e ndër ta thuhet se janë edhe dyshja kosovare Samir Ujkani dhe Mërgim Vojvoda.

Ibra: Nuk tërhiqem dot, luaj deri në moshën 50-vjeçar

Zlatan Ibrahimoviq po kalon një rini të dytë te Milani. Kuqezinjtë janë përmirësuar shumë prej momentit që 39-vjeçari suzedez nisi aventurën e dytë në Milanello. Rezultate pozitive, vendi i parë në Serie A për ekipin e Piolit, teksha bomberi suzedez kryeson renditjen e golashënuar me të mirë me 10 gola të realizuar në 6 ndeshje. Së fundmi ka marrë vlerësimin e radhës nga vendlindja. Ibrahimoviq është zgjedhur futbollisti më i mirë suzedez i vitit, duke fituar këtë çmim për herë të 12-të në karrierë. "Do të vazhdoj të luaj futboll deri në momentin që në stadiumë të rikthehen tifozët. Nuk mund ta mbyll karrierën time para tribunave të boshatisura. Jam 39-vjeç dhe fitova 'Topin e Artë' të Suedisë. Synimi im është ta fitoj këtë trofe edhe në moshën 50-vjeçare", ka deklaruar Ibra.

Boateng: Gjithmonë kam thënë se Ronaldo ishte më i miri në botë

Kevin-Prince Boateng ka thënë se te Barcelona e kishte vërejtur se sa i mirë ishte Lionel Messi, aq sa kishte menduar që të pensionohej përgjithmonë nga futbolli. 33-vjeçari ishte një huazim befasues te katalunasit në janar të vitit 2019 nga Sassuolo, ndërsa në "Camp Nou" arriti ta fitonte titullin e La Ligas, edhe pse kishte minutazh të kufizuar. Më pas, ai u transferua te Fiorentina, për të vazhduar te Besiktashi, para se të nënshkruante për klubin nga Serie B, Monza. "Gjashtë muajt e kaluar te Barcelona ishin të mahnitshëm. Në fillim, nuk e besova. Mendoja se më kërkonte Espanyoli, jo Barcelona e vërtetë!. Stërvitja me Messin më la pa fjalë. Gjithmonë kam thënë se Cristiano Ronaldo ishte më i miri në botë, por Messi është diçka tjeter. Ai nuk është normal. Derisa stërvitesha me të, për herë të parë në karrierën time ndihesha joadekuat (për këtë sport). Ai bënte gjëra të jashtëzakonshme. Më dukej sikur thosha me vete: 'Mora fund, nuk do të luaj më!', ka deklaruar Boateng për DAZN.



SHPALLJE PËR VEND TË LIRË TË PUNËS

Titulli: Recepzionist-e

Divizioni: i Sigurimit

Departamenti: i Administratës

Raporton: Udhëheqësit të Divizionit të Sigurimit

Grada: 10

Përbledhje e Detyrave dhe Përgjegjësive:

- Pranon palët/mysafirët e BQK-së;
- Identifikon, evidenton dhe pajis me kartelë të vizitorit çdo palë/mysafir që hyn në bankë;
- Mban dokumentin e identifikimit të vizitorëve (letërnjoftimin, pasaportën ose patentë shoferin) në këmbim të lëshimit të kartelës për vizitorë;
- Organizon dhe mirëmban regjistrin e vizitorëve;
- Njohuri themelore nga lëmia e sistemit financiar në Kosovë;
- Aftësi për kryerjen e detyrave me gjaktohtësi dhe pa zhurmë;
- Aftësi komunikative dhe iniciativë për t'iu shprehur çfarëdo provokimi nga palët e jashtme;
- Gatishmëri për të bashkëpunuar me personelin e sigurimit fizik dhe tërë personelin e BQK-së;
- Gatishmëri për t'u informuar në nivel bazik me çdo zhvillim në BQK.
- Jep udhëzimet e nevojshme vizitorëve dhe lajmëron personelin të cilit i bëhet vizita;
- Përcjellë mysafirët deri te nikojiri, nëse kërkohet nga mbikëqyrësi;
